

VENDIM
Nr.1, datë 22.3.2007

**I KOMITETIT TË PËRBASHKËT, REFERUAR MARRËVESHJES SË NDËRMJETME MBI
TREGTINË DHE ÇËSHTJET E LIDHURA ME TREGTINË NDËRMJET KOMUNITETIT
EUROPIAN NGA NJËRA ANË, DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, NGA ANA TJETËR,
QË MIRATON RREGULLOREN, PËRFSHIRË TERMAT E REFERENCËS DHE
STRUKTURËN E GRUPEVE TË PUNËS KE-SHQIPËRI**

Komiteti i Përbashkët,
duke pasur parasysh Marrëveshjen ndërmjet Komunitetit Ekonomik Europian dhe Republikës së Shqipërisë për Tregtinë dhe Bashkëpunimin Tregtar dhe Ekonomik (referuar më poshtë si “Marrëveshja”), që ka hyrë në fuqi më 1 dhjetor 1992, dhe në veçanti nenin 18 të saj;
duke pasur parasysh Marrëveshjen e Ndërmjetme për Tregtinë dhe çështjet e lidhura me Tregtinë ndërmjet Komunitetit Europian nga njëra anë dhe Shqipërisë nga ana tjetër (referuar më poshtë si “Marrëveshja e Ndërmjetme”), që u nënshkrua më 12 qershor 2006, dhe në veçanti nenet 42 dhe 43 të saj,
ndërsa Marrëveshja e Ndërmjetme hyri në fuqi më 1 dhjetor 2006,
vendosi si vijon:

Neni 1
Kryesimi

Komiteti i Përbashkët kryesohet në mënyrë të alternuar nga secila Palë.

Neni 2
Takimet

Komiteti i Përbashkët mbledhet rregullisht një herë në vit në Bruksel dhe në Tiranë, në mënyrë të alternuar. Mbledhjet e jashtëzakonshme të Komitetit të Përbashkët mbahen me marrëveshje të ndërsjellë, sipas kërkesës së secilës Palë.

Takimet e Komitetit të Përbashkët nuk janë publike, me përjashtim të rasteve kur bihet dakord ndryshe.

Neni 3
Delegacionet

Para çdo takimi, Kryetari duhet të informohet paraprakisht për përbërjen e miratuar të delegacionit të secilës Palë.

Një përfaqësues i Bankës Europiane të Investimeve (EIB) mund të marrë pjesë në takimet e Komitetit të Përbashkët si vëzhgues, në rastet kur axhenda përmban çështje që i interesojnë Bankës Europiane të Investimeve.

Komiteti i Përbashkët mund të ftojë persona joanëtarë të marrin pjesë në këto takime, me qëllim që të japin informacione për çështje specifike.

Shtetet Anëtare të Komunitetit Europian duhet të informohen për takimet e Komitetit të Përbashkët.

Neni 4
Sekretariati

Një zyrtar i Komisionit Europian dhe një zyrtar i Republikës së Shqipërisë veprojnë bashkërisht si sekretarë të Komitetit të Përbashkët.

Neni 5
Korrespondenca

Çdo korrespondencë që i dërgohet ose merret nga Kryetari i Komitetit të Përbashkët do t'i përcillet të dy sekretarëve. Dy sekretarët duhet që, në rastet e përshtatshme, t'ua kalojnë korrespondencat përfaqësuesve të tyre përkatës në Komitetin e Përbashkët.

Neni 6 **Axhenda e takimeve**

1. Kryetari dhe sekretarët hartojnë një axhendë paraprake për çdo takim, jo më vonë se 15 ditë pune përpara fillimit të takimit. Axhenda paraprake përmban pika diskutimi, kërkesa për përfshirjen e të cilave është marrë nga sekretarët jo më vonë se 21 ditë nga fillimi i takimit, përndryshe pikat e diskutimit nuk përfshihen në axhendën paraprake, me përjashtim të rasteve kur dokumentacioni mbështetës i dërgohet sekretarëve jo më vonë se data e dërgimit të axhendës. Axhenda miratohet nga Komiteti i Përbashkët në fillim të çdo takimi. Pika diskutimi, përveç atyre që përmban axhenda, mund të përfshihen në axhendë nëse të dy Palët bien dakord.

2. Me pëlqimin e të dy Palëve, Kryetari mund të shkurtojë afatet kohore të specifikuara në paragrafin 1, në mënyrë që të shqyrtojë kërkesat e një çështjeje specifike.

Neni 7 **Procesverbali**

Draftprocesverbali i takimit të Komitetit të Përbashkët përgatitet nga Pala pritëse e takimit. Ato duhet të përmbajnë vendimet dhe rekomandimet e marra, si dhe përfundimet e miratuara. Brenda dy muajsh pas takimit, draftprocesverbali i dërgohet Komitetit të Përbashkët për miratim. Pas miratimit, procesverbali nënshkruhet nga Kryetari dhe dy sekretarët dhe secila Palë mban nga një kopje origjinale. Një kopje e procesverbalit u dërgohet të gjithë të adresuarve të referuar në nenin 5 të këtij vendimi.

Neni 8 **Vendimmarrja**

Komiteti i Përbashkët i merr vendimet dhe formulon rekomandimet në marrëveshje të ndërsjellë ndërmjet Palëve. Gjatë periudhës ndërmjet sesioneve, Komiteti i Përbashkët mund të marrë vendime ose të bëjë rekomandime me procedurë me shkrim, në rast se të dy Palët janë dakord. Vendimet dhe rekomandimet e Komitetit të Përbashkët, brenda kuptimit të nenit 43 të Marrëveshjes së Ndërmjetme, emërohen përkatësisht “Vendim” dhe “Rekomandim” dhe shoqërohen nga një numër rendor, nga data e miratimit të tyre dhe një përshkrim i lëndës. Vendimet dhe rekomandimet e Komitetit të Përbashkët nënshkruhen nga Kryetari dhe certifikohen nga dy sekretarët. Vendimet që merr Komiteti i Përbashkët botohen nga Palët në publikimet e tyre përkatëse zyrtare. Secila Palë mund të vendosë nëse të publikojë apo jo ndonjë akt tjetër të miratuar nga Komiteti i Përbashkët.

Neni 9 **Gjuhët**

Gjuhët zyrtare të Komitetit të Përbashkët janë gjuhët zyrtare të të dy Palëve. Komiteti i Përbashkët i bazon shqyrtimet nga dokumentacioni i përgatitur në këto gjuhë, me përjashtim të rasteve kur vendoset ndryshe.

Neni 10 **Shpenzimet**

Secila Palë, Komuniteti dhe Republika e Shqipërisë, mbulojnë shpenzimet sipas pjesëmarrjes së tyre në takimet e Komitetit të Përbashkët dhe grupeve të punës si në varësi të stafit, shpenzimeve të

udhëtimit dhe akomodimit, ashtu edhe të kostove postare dhe telekomunikimit. Shpenzimet në lidhje me interpretimin, përkthimin dhe riprodhimin e dokumenteve të takimeve, si edhe çdo shpenzim tjetër që lidhet me organizimin fizik të takimeve, mbulohet nga Pala pritëse e takimeve.

Neni 11 Grupet e punës

Termat e referencës dhe struktura e grupeve të punës të ngritura në ndihmë të Komitetit të Përbashkët për kryerjen e detyrave të tij, paraqiten në shtojcën e këtij vendimi.

Grupet e punës përbëhen nga përfaqësues të të dy Palëve. Ato kryesohen në mënyrë të alternuar nga dy Palët, sipas rregullores së Komitetit të Përbashkët. Grupet e punës punojnë nën autoritetin e Komitetit të Përbashkët, të cilit i raportojnë pas çdo takimi. Grupet e punës nuk marrin vendime, por mund t'i japin rekomandime Komitetit të Përbashkët. Komiteti i Përbashkët mund të vendosë të anulojë ndonjë nga grupet ekzistuese të punës, t'ia modifikojë termat e referencës ose të ngrejë grupe të reja pune për ta ndihmuar në kryerjen e detyrave.

Nënshkruar në Bruksel, më 22 mars 2007.

Për Komitetin e Përbashkët
Kryetari
Dirk LANGE

SHTOJCË TERMAT E REFERENCËS DHE STRUKTURA E GRUPEVE TË PUNËS KE-SHIQIPËRI NËN MARRËVESHJEN E NDËRMJETME

1. Përbërja dhe Kryetari

Grupet e punës përbëhen nga përfaqësues të Komisionit Europian dhe përfaqësues të Republikës së Shqipërisë (më poshtë referuar si "Shqipëria"). Grupet e punës kryesohen në mënyrë të alternuar nga të dy Palët. Shtetet Anëtare duhet të informohen mbi takimet e grupeve të punës.

2. Sekretariati

Një zyrtar i Komisionit Europian dhe një zyrtar i Qeverisë së Shqipërisë veprojnë bashkërisht si sekretarë të secilit grup pune.

Të gjitha komunikimet ndërmjet grupeve të punës duhet t'u përcillen sekretarëve përkatës të grupit të punës.

3. Takimet

Grupet e punës mbledhen rregullisht një herë në vit dhe kurdo që e kërkojnë rrethanat, me marrëveshje ndërmjet dy Palëve. Çdo takim i grupit të punës mbahet në orarin dhe vendin e rënë dakord nga të dy Palët. Nëse të dy Palët janë dakord, grupet e punës mund të ftojnë ekspertë në takimet e tyre për të dhënë informacion specifik të nevojshëm.

4. Temat

Grupet e punës diskutojnë çështjet sipas strukturës shumëdisiplinore të grupeve të punës të paraqitura më poshtë. Do të bëhen vlerësime për të gjitha fushat përkatëse të Marrëveshjes së Ndërmjetme dhe Partneritetit Europian, përgatitjes për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe progresit në lidhje me përafrimin, implementimin dhe zbatimin e legjislacionit. Grupet e punës mund të shqyrtojnë problemet që mund të lindin në sektorët e tyre përkatës dhe mund të sugjerojnë marrjen e hapave të mundshëm. Grupet e punës shërbejnë edhe si forum diskutimi për qartësimin e mëtejshëm të *acquis communautaire*, dhe shqyrtojnë progresin që Shqipëria bën në përputhje me *acquis* dhe në kuadrin e angazhimeve nga Marrëveshja e Ndërmjetme.

5. Procesverbali

Projektprocesverbali i secilit takim të grupit të punës hartohet brenda dy muajsh pas takimit. Pas miratimit nga të dy Palët, sekretarët e grupit të punës i dërgojnë sekretarëve të Komitetit të Përbashkët një kopje të procesverbalit.

6. Publiciteti

Takimet e grupeve të punës nuk janë publike, me përjashtim të rasteve kur bihet dakord ndryshe.

7. Struktura e grupeve të punës

- 1) Grupi i punës për tregtinë, industrinë, doganat dhe tatimet
- 2) Grupi i punës për bujqësinë dhe peshkimin
- 3) Grupi i punës për tregun e brendshëm dhe konkurrencën
- 4) Grupi i punës për çështjet ekonomiko-financiare dhe statistikat
- 5) Grupi i punës për novacionet, shoqërinë e informimit dhe politikën sociale
- 6) Grupi i punës për transportin, mjedisin, energjinë dhe zhvillimin rajonal.

Nënshkruar në Bruksel, më 22 mars 2007.

Për Komitetin e Përbashkët

Kryetari

Dirk LANGE